



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

UNIVERSITETI I PRISHTINËS FAKULTETI FILOZOFIK

RAPORT I MONITORIMIT

30.05.2023, Prishtinë

1. HYRJE

Zyrtarët përgjegjës të Agjencionit të Kosovës për Akreditim (AKA) për procedurën e monitorimit:

- *Naim Gashi, Drejtor i AKA;*
- *Ilirijana Ademaj Ahmeti, Zyrtare e Lartë për Vlerësim dhe Monitorim;*
- *Jonida Berisha, Praktikante në AKA.*

Data e fillimit të procedurës së monitorimit: 17.05.2023

Monitorimi është realizuar: a) në distancë
b) me vizitë në terren me paralajmërim
c) me vizitë në terren pa paralajmërim

Data e vizitës monitoruese (nëse aplikohet): 17.05.2023

Personat me të cilët zyrtarët e AKA-së janë takuar në vizitën në terren (nëse aplikohet):

- *Rita Selimi, Zyrtare për cilësi në Fakultetin Filozofik;*
- *Dashamir Bërxulli, Dekan i Fakultetit Filozofik;*
- *Dorajet Imeri, Prodekan i Fakultetit Filozofik;*
- *Muhamet Qerimi, Prodekan i Fakultetit Filozofik.*

Burimet e informimit për raportin e monitorimit:

- *Orari i ligjëratave dhe punës praktike;*
- *Intervista me dekan dhe prodekanë.*

2. Përshkrim i shkurtër i zhvillimit të procedurës së monitorimit për verifikimin e orarit të ligjëratave dhe ushtrimeve, përfshirë të dhënat në rend kronologjik (nëse aplikohen):

Vizita monitoruese filloi në orën 10:45, në objektin e Fakultetit Filozofik në Prishtinë.

Gjate vizitës, ekipi monitorues u takua me znj. Rita Selimi koordinatorë për cilësi dhe z. Dashmir Bërxulli dekan në Fakultetin Filozofik. Bashkëpunimi i stafit ishte korrekt dhe ishin në dispozicion për të ofruar sqarime dhe përgjigje ndaj kërkesave të ekipit monitorues.

Ekipi monitorues fillimisht paraqiti kërkesë monitorim në sallat ku mbahej ligjëratat për programet të përzgjedhura nga ekipi monitorues me metodën e rastit.

Gjatë këtij aktivitetit, ekipi monitorues verifikoi mbarëvajtjen e mësimit disa nga sallat si në vijim:

- Salla nr. 05, në të cilën mbahej ligjëratat me prof. Muhamet Mala në departamentin e Historisë;
- Salla nr. 128, në të cilën mbahej ligjëratat me prof. Natyra Agoni, Psikologji;
- Salla nr. 103, në të cilën mbahej ligjëratat me prof. Erblin Kadriu Psikologji;
- Salla nr. 101, në të cilën ishte e planifikuar ligjëratat me prof. Hasnija llazi, në Filozofi, në të cilën nuk mbahej ligjëratat përshak të mungesës së studenteve.
- Salla nr. 102, në të cilën mbahej ligjëratat me prof. Arsim Sinani;
- Salla nr. 105, në të cilën mbahej ligjëratat me prof. Liridona Jemin Gashi;
- Salla nr. 106, në të cilën mbahej ligjëratat me prof. Zarita Halimi, Antropologji
- Salla nr. 109, në të cilën mbahej ligjëratat me prof. Vjollca Krasiqi, Pune Sociale;
- Salla nr. 114, në të cilën mbahej ligjëratat me prof. Tahir Latifi, Antropologji;
- Salla nr. 202, në të cilën mbahej ligjëratat me prof. Linda Gucia, Sociologji
- Salla nr. 201, në të cilën mbahej ligjëratat me prof. Bekim Baliqi, Shkenca Politike;
- Salla "Robert Schuman", në të cilën mbahej ligjëratat me prof. Jehona Lushaku.

Ekipi monitorues konstatoi se në të gjitha ambientet e mësimit ishin prezent mësimdhënësit si dhe studentët në përjashtim të një rasti.

Në vazhdim të vizitës monitoruese, ekipi është takuar edhe me zt. Dorajet Imeri dhe zt. Muhamet Qerimi dy prodekanë me të cilët ka biseduar për progresin, ligjëratat dhe aktivitetet tjera në Fakultetin Filozofik. Në fokus të bisedës, ka çështjet mësimore, përdorimi i bibliotekës nga studentët, mësimi online, etj. Ekipi monitorues kërkoi menaxhmenti i fakultetit dëshmi mbi vijueshmërinë e studentëve dhe mësimdhënësve.

3. VLERËSIMI PËRFUNDIMTAR


1. Ekipi monitorues ka konstatuar se mbarëvajtja e ligjeratave dhe punës praktike ka qenë në përputhje me oraret e paraqitura dhe publikuara.
2. Ekipi monitorues ka konstatuar se në ambientet e Fakultetit Filozofik nuk kanë qenë të ekspozuara oraret e ligjëratarave dhe ushtrimeve.
3. Shfrytëzimi i bibliotekës nga studentët është bërë vetëm deri në ora 12:00, pasi që institucioni ka deklaruar se ka mungesë të stafit lidhur me mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e bibliotekës.

4. SHTOJCAT (nëse aplikohet)

1.

Zyrtarët për Vlerësim dhe Monitorim të AKA-së

Kryesues

NAIM GASHI 
(Emri dhe Mbiemri) (Nënshkrimi) (Data)

Anëtar

Shijana Ademaj-Alumet 
(Emri dhe Mbiemri) (Nënshkrimi) (Data)

Anëtar

Jonida Benisha Dhalloshi 
(Emri dhe Mbiemri) (Nënshkrimi) (Data)